



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 28 korrik 2023, në mbledhjen e XIV-të (katërbëdhjetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; dhe Mrika Thaçi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës; z.Fatlum Osmani, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, z.Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA dhe znj.Adelina Stublla, Drejtoresh e Drejtorisë së shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, siç e keni parë edhe në materialet e dërguara për këtë mbledhje kemi 16 pika të rendit të ditës, mund të them se është një mbledhje paksa e ngarkuar por këto pika janë sjellë prej drejtorëve të Drejtorive dhe është dashtë të procedohen, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar për këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar për këtë mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 27.06.2023

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, pa plotësim ndryshime apo korrigjime, miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 27.06.2023, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, për vitin 2022

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Informatë e KKSB-së për aktivitetet gjatë viti 2022, e rekomandojmë për diskutim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

z.Haki Rudari, theksoi, Informata për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022 realisht është një informatë që neve na jep disa sqarime për vitin 2022 nga ana e përbërësve të këtij Këshilli. Në bazë të Udhëzimit Administrativ përkatës parashihet që KKSB ta informoj Kuvendin e Komunës 2 herë brenda vitit kalendarik, prandaj do të thoja që për vitin 2023 ta kemi një informatë të tillë në muajin shtatorë të këtij viti dhe atë për gjashtëmuajorin e parë të vitit dhe pastaj në fund të vitit të na sjellët edhe informata tjetër për gjashtëmuajorin e dytë.

Sa i përket kësaj informate që kemi paravetës për vitin 2022 në disa raste është e specifikuar ndoshta nga ana e Komandantit të Stacionit të policisë në Podujevës dhe disa përbërësve tjerë e që për mua ndoshta do të ishte më mirë të ishte prezent Komandanti i Stacionit sepse ka disa pyetje që ndërlidhen me Komandantin Stacionit të Policisë e që më bënë përshtypje është kur ai e cekë numrin e pjesëtarëve të policisë në Podujevë ku thotë se janë 103 gjithsejtë, prej tyre 8 me detyra të lehta, dhe një numër është në moshë të shtyrë, situatë kjo e cila na paraqet paksa problem në operim të përditshëm, prandaj kur thuhet se kemi një numër të policëve në moshë të shtyrë dhe na paraqet problem për operim të përditshëm mendoj se është goxha serioze dhe duhet të dihet arsyeja pse dhe a ka mundësi zëvendësimi.

Pastaj më tutje në raport thuhet se është bërë kërkesë nga Drejtoria Rajonale e Policisë për rritjen e stafit, prandaj për të gjitha këto do të ishte mirë nëse Komandanti do të ishte prezent këtu sepse shumë pyetje lidhen me Komandantin e Stacionit të Policisë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne sigurojmë se do ta njoftojmë Komandantin e Stacionit të Policisë për këtë edhe pse ai qysh jam i informuar shpesh herë i përcjellë mbledhje e Kuvendit, por që raportet e tij janë me KKSB-në dhe instancat tjera, kështu që besoj se edhe këtë problem që u cekë e kanë shqyrtuar në KKSB. Ne jemi në dijeni se problemin që u cekë ekziston në Stacionin e Policisë në Podujevë, ka staf të moshuar e që normale se duhet t'iu lihet ndonjë detyrë më e lehtë.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri (me 8 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë) Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

3. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Podujevës, për vitin fiskal 2022

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, lidhur me raportimin e auditimit të pasqyrave financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2022 materialin besoj se e keni marrë me kohë, po ashtu ky raport ka qenë i publikuar edhe në ueb faqen e Zyrës Kombëtare të Auditimit si dhe në ueb faqen e Komunës, kështu që vetëm mund t'i rekomandojmë për diskutim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë raport kështu siç ka ardhur andaj mendojmë se për më shumë do të ndalemi dhe të diskutojmë në seancën e radhës të Kuvendit që është caktuar të mbahet të hënën me 31.07.2023, prandaj si Grup e përkrahim rekomandimin që të kalon tutje për diskutim në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi i Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikët rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 9 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim / shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

4. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës, për periudhën Janar - qershor 2023

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, është obligim ligjor sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike që të raportohet, andaj materiali përkatës ju është përcjellë me kohë kështu që edhe këtë rekomandoj që të kalohet për diskutim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim raportin financiar janar - qershor 2023 dhe njëkohësisht të njëjtin e rekomandojmë për mbledhjen e Kuvendit të Komunës të caktuar për të hënë më datë 31.07.2023.

Kryesuesi i Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikët rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 9 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim / shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

5. Propozim Vendimi për transferim të buxhetit të komunës së Podujevës për vitin 2023

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, lidhur me transferimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 nga disa projekte të ndryshme, në kategorinë e mallrave në sektorin e arsimit të cilat më në detaje do t'i trajtojmë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, prandaj sot rekomandoj që të kaloj për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim për transferimin e buxhetit të Komunës për vitin 2023 dhe njëkohësisht e rekomandojmë për mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikët rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

6. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin “Furnizim me mekanizëm bujqësor”

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, lidhur me këtë propozim kemi të bëjmë për projektin përkatës të sektorit të bujqësisë, përkatësisht participimin e qytetarëve në vlerë prej 30% të projektit, andaj për implementimin e këtij kërkohet edhe vendim i Kuvendit në mënyrë që të mos paraqiten pengesa eventuale sa i përket mjeteve nga participimi i qytetarëve përfitues në këtë projekt, prandaj edhe e kemi sjellë si propozim në Kuvend që të miratohet shtimi i buxhetit nga participimi i qytetarëve për projektin në fjalë por edhe projektet tjera që janë në zbatim e sipër në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, andaj e rekomandojmë për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim propozimin e vendimit për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin “Furnizim me mekanizëm bujqësor”.

Kryesuesi i Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikët rendit të ditës që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

7. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin “Furnizim me sera”

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, kemi të bëjmë me të njëjtën çështje sikurse ajo paraprake por vetëm bëhet fjalë për projekt tjetër që është furnizim me sera andaj edhe për këtë i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të këtij propozim vendimi.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, edhe këtë pikë që është propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin “Furnizim me sera”, e përkrahim ne Grupi i LVV-së

Kryesuesi i Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikët rendit të ditës që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

8. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, ky propozim si çështje ka qenë edhe rekomandim nga mbledhja e kaluar e KPF-së që për këtë mbledhje të sjellët si propozim për këtë mbledhje dhe mbledhjen e Kuvendit që do të mbahet të hënën më 31.07.2023, kështu që propozimin e keni marrë me kohë andaj rekomandoj që të kalohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Kuvendit.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, këtë vendim e kemi përkrahur dhe e përkrahim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në seancën e të hënës më 31.07.2023.

z.Naim Çunaku, theksoi, në mbledhjen e kaluar kjo çështje ishte propozim i imi, mirëpo si duket vetëm pse ka qenë propozim i imi është bërë ky modifikim kështu siç është bërë.

Kryesuesi i Komitetit, kjo çështje ka qenë iniciativë e kolegut z.Naim Çunaku që të bëhet një gjë e tillë, por që në atë mbledhje është marrë si përfundim që kjo çështje të lihet për një mbledhje të ardhshme, konkretisht për këtë mbledhje në mënyrë që Drejtoritë përkatëse të sjellin një propozim konkret, andaj tani kemi propozimin dhe mund ta shqyrtojmë në këtë mbledhje apo në mbledhjen e Kuvendit.

Pra meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikët rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe 3 vota të Përmbajtura, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

9. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për vitin shkollor 2022-2023

z.Avni Fetahu, Drejtor i DKA, theksoi, duke pasë parasysh se Informata si e tillë do të diskutohet edhe në mbledhjen e Kuvendit e shoh të arsyeshme që në pika të shkurtra t'ju them se e kemi paraqitur një Informatë të përgjithshme ashtu siç ka qenë e planifikuar me planin e punës së Kuvendit. Në këtë Informatë janë përfshirë aktivitetet e planifikuara dhe ato të realizuara gjatë kësaj periudhe kohore, pastaj janë përfshirë edhe investimet e bëra në shkolla dhe ato që planifikohen të bëhen, rezultatet dhe të arriturat e nxënësve në nivelet I; II dhe III të arsimit parauniversitar dhe po ashtu në shkollat e mesme.

Janë projektet që janë realizuar nga DKA qoftë si aktivitete qoftë si kapitale, në të njëjtën kohë është përfshirë edhe sigurimi i transportit të nxënësve, ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkollore, rregullimi dhe rrethimi i oborreve të shkollave, bashkëpunimet me Stacionin Policor në Podujevë, sfidat me çka jemi ballafaquar, organizimi i garave të nxënësve e të tjera.

Pra kjo ishte në pika të shkurtra rreth kësaj informate, çështjet tjera sigurisht se do t'i diskutojmë në seancën e Kuvendit të Komunës.

z.Haki Rudari, theksoi, me këtë Informatë që na është dërguar dhe që tani e paraqiti në pika të shkurtra edhe drejtori i DKA-së kemi shumë specifika që janë kryer në këtë drejtori, po ashtu edhe shumë aktivitete të planifikuara dhe të realizuara, shumë projekte në infrastrukturë dhe investime të ndryshëm, po ashtu kemi edhe notën mesatare të nxënësve të nivelit të I dhe të II të arsimit fillor si dhe të nivelit të arsimit të lartë. Në përgjithësi ka shumë projekte të cilat me të vërtetë janë projekte të mëdha që janë realizuar dhe që janë në interes të qytetarëve e në veçanti të nxënësve, prandaj ne Grupi i LVV-ës e përkrahim dhe i rekomandojmë për diskutim në seancën e Kuvendit.

Kryesuesi i Komitetit, meqë nuk ka pati të interesuar për diskutim, e hedh në votim këtë pikët rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në seancën e datës 31.07.2023.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

10. Propozim Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 - 2025
- Raporti nga konsultimi publik

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim Raportin e diskutimit publik të propozim Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 – 2025, dhe njikophësisht i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

11. Propozim Plani i veprimt për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023 – 2026 në Komunën e Podujevës
-Raporti nga konsultimi publik

z.Haki Rudari, theksoi, realisht kemi dy raporte nga konsultimi publik për këto dy dokumente e për të cilin e përkrahëm paraprakisht, andaj edhe në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim edhe këtë raporti sipas kësaj pike të rendit të ditës dhe njëkohësisht rekomandojë që të kalojë për shqyrtim në senacën e Kuvendit.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

12. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal afariste në qytet rr. “Skënderbeu”
-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, duke e paraqitur këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, ne DPKGJ kemi bërë përgatitjen e propozim vendimeve për dhëni në shfrytëzim të pronave të paluajtshme ku janë të përfshira gjithsejtë 4 parcela që i kemi në Zonën kadastrale Lupç i Poshtëm dhe 1 në Zonën kadastrale Podujevës ku përfshihen dy lokale afariste.

Pra kjo ishte për këtë pikë dhe pikat pasuese të cilat janë propozuar për miratim paraprak së bashku me propozim vendimet për formimin e komisioneve përkatëse, andaj rekomandoj për diskutim dhe shqyrtim në këtë dhe mbledhje dhe në mbledhjen e Kuvendit që është caktuar të mbahet më 31.07.2023.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal afariste në qytet rr. “Skënderbeu”, dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

13. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00495-4 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës dhe ato pasuese Drejtoresha parafolëse e paraqiti fjalën hyrëse, pra janë pika të ngjashme si ajo paraprake, andaj urdhëroni.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

14. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00202-1 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV-së edhe këtë pikë të rendit të ditës e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

15. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00209-0 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së edhe këtë pikë të rendit të ditës e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

16. Propozim Vendimi për vënie në konsultim publik - Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF- Komuna e Podujevës

znj. Adelinë Stublla, Drejtoresh e DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pra kemi të bëjmë me draft Statutin e Qendrës së Mjekësisë Familjare e cila ka qenë edhe në planin e punës së Kuvendit për vitin 2023, dokument ky i cili është sjellë për shqyrtim fillestar dhe njëkohësisht për vënie në konsultim publik.

Kohëzgjatje dhe datat dhe data e konsultimit publik do të caktohen të hënën në mbledhjen e Kuvendit, andaj besoj se do të përkrahet dhe t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF- Komuna e Podujevës, që i njëjti të del në konsultim publik.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023, kohëzgjatja dhe data e konsultimeve publike të caktohen në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

**Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli**

**Nr. Prot. 01-060/04-0054932/23
Podujevë,
28 korrik 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**